



**BASHKIMI EVROPIAN
MISIONI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE
ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE –
KOSOVË* 2017**

DEKLARATË PRELIMINARE

13 qershor 2017

Zgjedhjet ishin vërtet konkurruese në pjesën më të madhe të Kosovës, por kërkohet vullnet politik për adresimin e dobësive të vjetra dhe frikësimit në rajonet e banuara me serbë të Kosovës

PËRMBLEDHJE

- Zgjedhjet e parakohshme të 11 qershorit 2017 ishin vërtet konkurruese dhe të qeta në pjesën më të madhe të Kosovës, dhe votuesve përgjithësisht ju ofruan informacione pluraliste për opsionet e ndryshme politike. Megjithatë, procesi zgjedhor u ndikua negativisht nga dobësitë e vjetra, veçanërisht: nga listat e pasakta të votuesve që janë të cenueshme ndaj mashtrimeve, një sistem zgjedhor që lë mundësi për abuzim, dhe sistem me shumë të meta për votim jashtë Kosovës. Këto çështje do të kërkojnë vullnet dhe përkushtim politik për të bërë reformat e nevojshme.
- Në zonat me shumicë serbe, procesi zgjedhor u dëmtua nga frikësimi dhe rastet e dhunës brenda komunitetit serb të Kosovës kundër kandidatëve dhe votuesve, si dhe nga reagimi i pamjaftueshëm nga prokuroria dhe policia. Kjo ngrit pyetjet rreth besueshmërisë së procesit demokratik në këto zona.
- Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe nuk u vërejt asnjë incident i theksuar nga EU EOM, përfshirë edhe veriun e Kosovës. Votimi në përgjithësi u vlerësua pozitivisht; megjithatë vëzhguesit vërejtën raste të shpeshta të votimit familjar, raste të ndihmës abuzive të votuesve, dhe pranisë së tepërt të vëzhguesve nga dy subjekte politike duke e shkelur ligjin. Procedurat e numërimit të votave nuk u përfillën gjithmonë, duke nënvizuar nevojën për trajnim më të mirë të stafit zgjedhor. Prania e madhe e grupit të vëzhguesve vendorë të Demokracisë në Veprim i kontribuoi transparencës dhe integritetit të zgjedhjeve.
- Këto zgjedhje parlamentare, sikurse ato të mëparshmet, u mbajtën brenda periudhës më të shkurtër kohore të mundshme. Kjo ka ndikuar negativisht në tërë procesin, përfshirë edhe në të drejtën për mjete juridike efektive, si dhe në kapacitetin e administrimit zgjedhor për të garantuar transparencën dhe integritetin e procesit.
- Për shkak të shqetësimit shumë të pranishëm që si pasojë e dy vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2014 vetëm subjektit politik që merr më së shumti ulëse mund t'i jepet mundësia që të formojë ekzekutivin e ardhshëm, shumica e partive kryesore të shqiptarëve të Kosovës u rigrupuan në koalicione parazgjedhore të minutës së fundit. Duke marrë parasysh sistemin zgjedhor me lista të hapura, kjo çoi në rivalitet ndërmjet partive politike brenda këtyre koalicioneve parazgjedhore meqë ato duhej të garonin për vota preferenciale në të njëjtat lista. Kjo e bëri edhe vëzhgimin nga përfaqësuesit e pjesëmarrësve në zgjedhje më kompleks, dhe e bëri çështje kontestuese emërimin e këshillave të vendvotimeve.
- Me përjashtim të zonave me shumicë serbe, atmosfera e fushatës ishte kryesisht e qetë, duke u mundësuar subjekteve politike të përcjellin mesazhet lirshëm tek votuesit.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është politikisht përfshirës, takimet e tij në përgjithësi kanë qenë të hapura dhe ai kryesisht vepron në mënyrë transparente. Ai është përpjekur të marrë vendimet me konsensus, dhe si rregull, bëri përpjekje të zhvillojë një proces transparent dhe të mirëfilltë. Megjithatë, kishte vonesa në zbatimin e informimit të

* Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

votuesve, në publikimin e vendimeve dhe në miratimin e masave parandaluese kundër mashtrimit.

- Për këto zgjedhje KQZ-ja ka regjistruar 1,872,941 votues bazuar në të dhënat e regjistrave civil. Listat e votuesve vazhdojnë të jenë çështje shqetësuese, veçanërisht prania e emrave të personave të vdekur, fakti se votuesit nuk caktohen në mënyrë konsekuente në vendvotimin më të afërt dhe rreziqet se të dhënat e votuesve që banojnë jashtë vendit në listat e votuesve të komunave nga vijnë ata mund të keqpërdoren në ditën e zgjedhjeve.
- Kishte udhëzime të paqarta se a duhet të pranohen dokumentet e identifikimit të Serbisë si dokumente të vlefshme identifikimi për votim. Kjo rezultoi në konfuzion në disa vendvotime të caktuara gjatë ditës së zgjedhjeve.
- Procesi i votimit jashtë Kosovës (VJK) u ndikua në mënyrë të veçantë nga periudha e shkurtuar kohore. Popullsia që jeton jashtë vendit vlerësohet të jetë afër 500,000. KQZ-ja ka pranuar 20,354 aplikacione, 15,118 prej të cilave u regjistruan. Ndonëse ata që banojnë jashtë vendit kanë të drejtë të votojnë, si metoda e votimit jashtë Kosovës ashtu edhe zbatimi i saj kanë dështuar të ofrojnë një sistem funksional, gjithëpërfshirës dhe i mbrotjur ndaj mashtrimeve për ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar.
- Kosova ka një ambient mediatik pluralist dhe një kornizë të shëndoshë ligjore për liri të mediave. Ligji për zgjedhjet kërkon mbulim të drejtë dhe të paanshëm nga mediat, lejon reklamimin me pagesë dhe përcakton edhe një kohë transmetuese pa pagesë. Dispozitat e paqarta ligjore u kanë mundur garuesve të blejnë gjerësisht mbulueshmëri të sponsoruar të ngjarjeve të fushatës, përveç reklamimit të paguar politik që rregullohet në mënyrë të rreptë.
- Mediat e mbuluan gjerësisht fushatën zgjedhore dhe në përgjithësi u ofruan votuesve informata pluraliste për forcat politike që ishin në garë. Mbulueshmëria me lajme nga kanalet kryesore televizive ishte përgjithësisht e balancuar dhe i paanshëm. Megjithatë, në përpjekje për të organizuar debate zgjedhore në pajtim me ligjin ato përjetuan ndërhyrje shqetësuese nga koalicioni PAN, i cili kërkoi trajtim favorizues. Komisioni i Pavarur për Media luajti kryesisht një rol pasiv.
- Para ditës së zgjedhjeve, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) mori 18 ankesa kundër vendimeve të KQZ-së, dhe 171 ankesa për shkelje të pretenduara zgjedhore. Shumica kishin të bënin me shkeljet e Kodit të Sjelljes gjatë bërjes së fushatës dhe u gjykuan me shpejtësi nga PZAP. Rreth 131 ankesa janë parashtruar lidhur me ditën e zgjedhjeve, shumica për shkeljen e heshtjes zgjedhore dhe 32 lidhur me votimin.

Me ftesën e Presidentit të Kosovës të datës 11 maj 2017, BE e dërgoi një Mision Vëzhgues të Zgjedhjeve (EOM) me 19 maj për të vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të caktuara të mbahen me 11 qershor 2017. EU EOM udhëhiqet nga Z. Alojz Peterle, deputet i Parlamentit Evropian dhe ish Kryeministër i Republikës së Sllovenisë. Një delegacion i Parlamentit Evropian i udhëhequr nga deputeti i PE-së Igor Šoltes iu bashkua EU EOM-it pak para ditës së zgjedhjeve. Në total, EU EOM-i shpërndau në tërë Kosovën 103 vëzhgues nga 25 shtete anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra, për të vlerësuar tërë procesin zgjedhor në raport me standardet ndërkombëtare dhe evropiane për zgjedhje demokratike dhe me ligjet e Kosovës. Misionit iu bashkuan edhe 40 vëzhgues nga përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare të BE-së dhe të Norvegjisë, si dhe nga Zyra e BE-së/EUSR për të

vëzhguar procesin në ditën e zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit vizituan 450 vendvotime për të vëzhguar votimin dhe numërimin.

Kjo deklaratë preliminare publikohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve pjesërisht do të varet nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, veçanërisht nga tabelimi i rezultateve dhe zgjidhja e parashtrësive dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. EU EOM-i mbetet në Kosovë për të vëzhguar zhvillimet pas zgjedhjeve dhe do të publikojë një raport përfundimtar që përmban rekomandime të hollësishme, brenda dy muajsh pas përfundimit të procesit zgjedhor. EU EOM-i është e pavarur në gjetjet dhe konkluzionet e tij dhe bazohet në Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005.

GJETJET PRELIMINARE

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Pas mocionit të mosbesimit të votuar në Kuvend me 10 maj, Presidenti i Kosovës shpalli zgjedhjet e parakohshme parlamentare të caktuara për tu mbajtur me 11 qershor. Votuesit e Kosovës u ftuan që të zgjedhin 120 deputetët e Kuvendit përmes një sistemi proporcional të përfaqësimit me votim preferencial, me ulëse të garantuara për komunitetet joshumicë dhe me kuota gjinore prej 30 për qind. Këto janë zgjedhjet e treta parlamentare që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2014, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në njërën anë, dhe koalicioni paszgjedhor i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës për Kosovën (NISMA) të mbështetura nga Vetëvendosje në anën tjetër, pretenduan të drejtën për të propozuar Kryetarin e Kuvendit dhe për të formuar ekzekutivin. Këto çështje u vendosen nga Gjykata Kushtetuese. Në aktgjykimin AGJ 671/14 të datës 1 korrik 2014 mbi kompetencat e Presidentit të Kosovës, ajo vendosi se partisë ose koalicionit parazgjedhor që ka fituar shumicën e ulëseve duhet t'i jepet mundësia e parë e përcaktuar sipas kushtetutës për të propozuar kandidatin për Kryeministër. Për më tepër, ajo theksoi se nuk duhet përjashtuar që Presidenti i Kosovës mund t'ia jap të njëjtës parti ose koalicion mundësinë e dytë dhe të fundit për të propozuar një kandidat tjetër, por konsideroi se Presidenti duhet të vlerësojë cila parti politike ose koalicion ka gjasat më të mëdha që të propozojë një kandidat që do t'i marrë votat e nevojshme në Kuvend për formimin e ekzekutivit të ri.

Shumica e partive kryesore politike në Kosovë duket se kanë ardhur në përfundim nga ky vendim dhe nga vendimi i më pastajmë i GJK-së AGJ 700/14 se të dy mundësitë e parapara kushtetuese për të propozuar Kryeministrin dhe formuar ekzekutivin do t'i jepen subjektit të njëjtë më të madh politik parazgjedhor. Një pasojë e drejtpërdrejtë nga kjo duket të jetë mënyra në të cilën partitë politike janë shtyrë që të bëjnë koalicione para zgjedhjeve të 11 qershorit përkundër dallimeve rrënjësore mes tyre.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka formuar një koalicion parazgjedhor me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Nismën për Kosovën (NISMA) dhe partitë e vogla. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca Kosova e Re (AKR) formuan një koalicion tjetër. Prej partive më të mëdha shqiptare në Kosovë, vetëm Vetëvendosje garoi si e vetme.

Për dallim nga komuniteti shqiptar i Kosovës, spektri politik i komunitetit serb të Kosovës ishte i fragmentuar, me subjekte politike si Partia e Serbëve e Kosovës (PKS), Partia Liberale Serbe (SLS) dhe Partia Demokratike Progresive (PDS) që sfiduan dominimin e Listës Serbe. Zyrtarë të lartë serbë u bënë thirrje votuesve në disa raste për të votuar për Listën Serbe.

KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në pajtim me standardet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj,¹ por përmban dispozita sfiduese për zgjedhjet e parakohshme. Nga viti 2011, ka pasur disa përpjekje të pasuksesshme për reformim gjithëpërfshirës të sistemit zgjedhor dhe për të adresuar mangësitë e identifikuara më herët, përfshirë mundësinë e shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme brenda një kohe jashtëzakonisht të shkurtër, si rezultat duke i shkurtuar afatet kohore në kalendarin zgjedhor, përfshirë edhe periudhën e fushatës.

Sipas legjisllacionit aktual, zgjedhjet e parakohshme duhet të mbahen ndërmjet 30-45 ditësh pas shpërbërjes së Kuvendit, një afat kohor jashtëzakonisht i shkurtër. Presidenti i Kosovës vendosi që të shpall zgjedhjet në datën më të hershme të mundshme, duke krijuar nevojën për shkurtime tepër të theksuar të afateve në kalendarin e zgjedhjeve. Kjo paraqiti vështirësi shtesë për organizimin e zgjedhjeve dhe për afatet kohore për parashtrësia dhe ankesa para datës së zgjedhjeve, duke kufizuar kështu pjesërisht të drejtën në mjete juridike efektive. Fushata zyrtare po ashtu u reduktua në dhjetë ditë.

SISTEMI ZGJEDHOR

120 deputetët e Kuvendit të Kosovës zgjidhen për mandat katërvjeçar në një zonë të vetme zgjedhore përmes sistemit proporcional me ulëse të garantuara për komunitetet joshumicë, me një kuotë gjinore dhe me votim preferencial për kandidatët. Prej 120 mandateve në Kuvend, 20 ulëse janë të garantuara për komunitetet joshumicë, përfshirë 10 për komunitetin serb të Kosovës.²

Votuesit e shënojnë zgjedhjen e tyre për subjektin politik e po ashtu i shënojnë edhe preferencat për deri në pesë kandidatë nga subjekti i zgjedhur politik. Nëse në fletëvotim janë shënuar më shumë se pesë kandidatë, preferencat bëhen të pavlefshme dhe numërohet vetëm vota për subjektin politik.

Nga ulëset që i caktohen një subjekti politik, gjinia e cila ka marrë më pak ulëse kërkohet të ketë të paktën 30% të numrit të përgjithshëm të ulëseve të fituara nga subjekti politik. Nëse nuk është kështu atëherë kandidatët me më së paku vota të gjinisë së mbipërfaqësuar zëvendësohen nga kandidati/ja i/e radhës në listë nga gjinia e nën-përfaqësuar. Zëvendësimet vazhdojnë derisa të dy gjinitë të kenë së paku 30% të ulëseve.

¹ Kushtetuta e Kosovës e thekson zbatimin e drejtpërdrejtë të disa marrëveshjeve dhe dokumenteve ndërkombëtare, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj, dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

² Dhjetë ulëset e mbetura shpërndahen si vijon: komunitetin rom (1 ulëse), komuniteti ashkali (1 ulëse), komuniteti egjiptian (1 ulëse), komuniteti rom, ashkali ose egjiptian me numrin më të madh të përgjithshëm të votave (1 ulëse), komuniteti boshnjak (3 ulëse), komuniteti turk (2 ulëse) dhe komuniteti goran (1 ulëse).

ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

KQZ është organ i përhershëm i pavarur i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë. Personi që e kryeson atë, që aktualisht është grua, emërohet nga Presidenti i Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Dhjetë anëtarët e tjerë të KQZ-së emërohen pas propozimit nga grupet parlamentare në Kuvend, përfshirë edhe ata që mbajnë ulëset e garantuara për komunitetet joshumicë. Takimet e KQZ-së janë të hapura për vëzhguesit, publikun dhe mediat. KQZ ka miratuar shumicën e vendimeve të tij si organ kolegjal; megjithatë, ka pasur disa debate kontestuese në të cilat anëtarët e KQZ-së kanë shkëmbyer akuza për mbështetjen e interesave të ndonjë subjekti të caktuar politik.

Komisione Komunale Zgjedhore (KKZ-të) përbëhen nga shtatë deri në njëmbëdhjetë anëtarë të propozuar nga subjektet politike që kanë kaluar pragun prej 5% në zgjedhjet parlamentare dhe nga subjektet politike të komuniteteve joshumicë. Vëzhguesit e EU EOM-it i vlerësuan KKZ-të si kompetente dhe të përgatitura mirë.

Emërimi i 2,490 Këshillave të Vendvotimeve (KVV) ishte kontestues. Për faktin se shumë prej partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës po garojnë së bashku në koalicione parazgjedhore (d.m.th., si një ‘subjekt politik’), procedura e zakonshme e propozimit të tyre u bë jopraktike. KQZ, me detyrë të mbyllura, krijoi një formulë e cila u përpoq të sigurojë një përfaqësim adekuat politik në KVV. Ky fleksibilitet lejohet me ligj, nëse e kërkon nevoja.³ KQZ u përfshi në diskutim të nxehtë lidhur me propozimet fillestare të anëtarëve të KVV-ve në komunat veriore meqë përbërjes së tyre u mungonte një përfaqësim gjithëpërfshirës dhe i balancuar i subjekteve politike garuese të komunitetit serb.⁴

Përfaqësimi i grave në administrimin e zgjedhjeve është shumë i ulët. Nga 11 anëtarët e KQZ-së, vetëm kryesuesja është grua, dhe gratë përfaqësojnë vetëm 10.5 % të anëtarëve dhe kryesuesve të KKZ-ve. Gratë përfaqësuan 24% të anëtarëve dhe 18% të kryesuesve në vendvotimet e vizituara nga EU EOM-i.

PERIUDHA E SHKURTUAR KOHORE PËR ZGJEDHJET

Mbajtja e zgjedhjeve në afatin më të shkurtër të mundshëm kohor ka ndikuar negativisht në tërë procesin, përfshirë edhe parashtresat dhe ankesat parazgjedhore. Nuk u përmbushën disa afate ligjore, siç është certifikimi i kandidatëve për listat e komuniteteve joshumicë, emërimi i këshillave të vendvotimeve dhe dërgimi i materialeve zgjedhore për votuesit e regjistruar për votim jashtë Kosovës. Kombinimi i afateve të shkurtuara të administrimit të zgjedhjeve me afatet për parashtresa dhe ankesa mund të ndikojë në të drejtën për mjet juridik efektiv siç përcaktohet më poshtë për votimin jashtë Kosovës dhe përfaqësimin e joshumicës.

LISTAT E VOTUESVE

Për këto zgjedhje, KQZ ka regjistruar 1,872,941 votues bazuar në shënimet e ofruara nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC). Listat e votuesve përmbajnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë që banon jashtë vendit, që vlerësohet të jenë rreth 562,951 sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011. Për këto zgjedhje, votuesit patën mundësi të kufizuara për të verifikuar

³ Shih nenin 77.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme

⁴ Në KVV-të e emëruara, Lista Serbe (GISL) ka 22 nga 31 kryesuesit e KVV-ve në komunën e Leposaviqit, 6 nga 13 kryesuesit e KVV-ve në komunën e Zveçanit, 17 nga 28 kryesuesit e KVV-ve në Mitrovicën e veriut dhe 7 nga 15 kryesuesit e KVV-ve në Zubin Potok.

të dhënat e tyre në listën e votuesve dhe të kërkojnë ndryshime, kryesisht për shkak të afateve të shkurtuara kohore dhe fushatës së kufizuar të informimit.

Listat e votuesve janë çështje për brengosje. Mangësitë përfshijnë dështimin për të hequr të gjithë emrat e personave të vdekur, dhe praninë e votuesve që banojnë jashtë vendit në listat e votuesve të komunës nga e kanë prejardhjen. Kjo krijon mundësi për manipulim në ditën e zgjedhjeve. Po ashtu duket se votuesit jo gjithmonë janë caktuar në vendvotimet më të afërta me vendin ku banojnë, që siç raportohet është për shkak të mangësive në sistemin e adresave të Kosovës, dhe për faktin se KQZ-ja përdor vendbanimin e votuesve ashtu siç është regjistruar në kohën e lëshimit të dokumenteve të identifikimit, ndërkohë që ata mund ta kenë ndërruar vendbanimin.

PROCESI ZGJEDHOR NË KATËR KOMUNAT VERIORE

Në pajtim me marrëveshjen ndërmjet KQZ-së dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe si masë për ndërtimin e besimit, personeli ndërkombëtar i OSBE-së ishte i pranishëm në secilën KVV në komunat veriore për t'i këshilluar dhe ndihmuar, dhe me autoritetin për t'i raportuar KQZ-së për shkeljet. Personeli i OSBE-së po ashtu përcolli transportimin e materialeve të ndjeshme nga KQZ-ja.

Numri i përgjithshëm i votuesve në katër komunat veriore është zvogëluar krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2014 nga 62,797 në 58,064. Ky ndryshim është pjesërisht për shkak të mosintegritetit të të dhënave nga regjistri civil i Serbisë në listat e votuesve, siç ishte bërë për zgjedhjet e vitit 2014 si rezultat i dialogut të Brukselit.

Kishte udhëzime të paqarta nga KQZ-ja se a duhet të pranohen dokumentet e identifikimit të Serbisë si dokumente të vlefshme identifikimi për votim në katër komunat veriore. Kjo solli një lloj konfuzioni në ditën e zgjedhjeve në Leposaviq dhe zonat e tjera.

Në ditën e zgjedhjeve, rreth 30 autobusë nga Serbia sollën votuesit në disa komuna me shumicë serbe. Procesi ishte raportuar të ketë shkuar mirë.

VOTIMI JASHTË KOSOVËS PËRMES POSTËS

KQZ ka pranuar 20,354 aplikacione për votim jashtë Kosovës. 15,118 e tyre u regjistruan me sukses dhe 5,236 u refuzuan, kryesisht për mungesë të dëshmisë mbi të drejtën për të votuar. Numri më i madh i aplikacioneve për votim jashtë Kosovës ishin nga Zvicra (5,432), Gjermania (4,340) dhe Serbia (4,395). Numri më i madh i aplikacioneve të refuzuara ishte nga Serbia (2,476), për shkak të numrit të madh të aplikuesve që nuk kishin ofruar dokumente të mjaftueshme që dëshmojnë të drejtën e tyre për të votuar.⁵ Numri i përgjithshëm i votuesve nga Serbia të regjistruar për votim jashtë Kosovës ishte 1,919.

Sipas KQZ-së, problemet teknike lidhur me sistemin e emailit të KQZ-së rezultuan në numër të madh të aplikacioneve të shumëfishta që e hutuan Divizionin e Shërbimit të Votuesve të KQZ-së (DSHV), pasi që votuesit potencial u përpoqën të dërgojnë aplikacionet e tyre disa herë. Lista përfundimtare e votuesve jashtë Kosovës përmban emra të regjistruar disa herë. DSHV mori nga posta 4,600 fletëvotime përmes postës të votuesve jashtë Kosovës në zarfe

⁵ Sipas nenit 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), aplikuesit duhet të dëshmojnë se janë regjistruar në sistemin e Kosovës, se kanë jetuar në Kosovë deri në vitin 1998, ose se e kanë marrë statusin e refugjatit pas vitit 1995.

dhe në ditën e zgjedhjeve filloi procesin e verifikimit të të drejtës së votuesve dhe vlefshmërinë e zarfeve për votim jashtë Kosovës.

Derisa pjesëtarët e diasporës së Kosovës kanë të drejtë të votojnë, edhe metoda e votimit jashtë Kosovës dhe zbatimi i saj kanë dështuar të ofrojnë në sistem funksional, përfshirës dhe rezistues ndaj mashtrimeve për ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar.

CERTIFIKIMI I GARUESVE NË ZGJEDHJE

Të 26 subjektet politike që aplikuan të garojnë në zgjedhje u certifikuan nga KQZ me 23 maj. Morën pjesë gjithsej pesë koalicione, 19 parti politike dhe dy iniciativa qytetare. Njëzet e një subjekte politike garuan për 20 ulëset e garantuara për komunitetet joshumicë, ndërsa pesë subjekte politike të shumicës shqiptare garuan për 100 ulëset e tjera. Në përgjithësi, u certifikuan 971 kandidatë. 487 kandidatë garuan në pesë listat që garonin për 100 ulëse, ndërsa 484 kandidatë garuan në 21 listat që garonin për 20 ulëset e garantuara.

Certifikimi i kandidatëve ishte kryesisht pa kundërthënie; megjithatë, një kontest i ndërlikuar ndodhi lidhur me certifikimin e shqiptarëve të pretenduar 'etnik' të Kosovës të prezantuar si kandidatë në dy lista që garonin për ulëset e rezervuara për komunitetet joshumicë. Këto raste ilustronë dobësitë në sistem për përfaqësimin e partive joshumicë, veçanërisht mjetet e paqarta ligjore që KQZ i ka në dispozicion të parandalojë abuzimet, dhe mosgarantimi i të drejtës për mjet juridik efektiv kur zgjedhjet mbahen brenda një periudhe të shkurtuar kohore.

AMBIENTI I FUSHATËS

Fushata zyrtare filloi me 31 maj dhe përfundoi 24 orë para hapjes së vendvotimeve. Siç kishte ndodhur edhe në zgjedhjet e mëhershme, subjektet politike filluan aktivitetet e fushatës para fillimit zyrtar të fushatës. Atmosfera e fushatës ishte kryesisht e qetë dhe e profilit të ulët në zonat me shumicë shqiptare, e cila u intensifikua kah fundi, me tubime më të mëdha që u mbajtën nga koalicionet e mëdha dhe nga Vetëvendosje. Garuesit e bënë fushatën në mënyrë të lirë dhe përgjithësisht u përmbajtën nga gjuha nxitëse.

Sidoqoftë, ambienti i fushatës u dëmtua nga një formë e frikësimit brenda komuniteteve serbe, veçanërisht ato që preknin partitë dhe kandidatët e partive që nuk ishin pjesë e Listës Serbe. Kjo përfshiu presionin mbi kandidatët individual për tu tërhequr nga gara. Ndodhën edhe incidente të dhunshme të izoluara, përfshirë një sulm me të shtëna armësh kundër zyrës së PKS-së në Leposaviq me 22 maj dhe një incident i dhunshëm ku ishin përfshirë përkrahësit e PKS-së dhe Listës Serbe, i cili rezultoi me paraburgim të përkohshëm të udhëheqësit të PKS-së me 4 qershor.

Kodi i Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre e ndalon shfrytëzimin e resurseve të pozitës publike për të bërë fushatë, si dhe frikësimin e votuesve. Subjektet politike në përgjithësi u janë përmbajtur rregullave të fushatës të përcaktuara në Kodin e Sjelljes. Megjithatë, vëzhguesit e EU EOM-së pranuan disa raporte për shfrytëzimin e pozitive publike për qëllime të fushatës.⁶ Vëzhguesit e EU EOM-së morën raporte për blerje votash nga Lista Serbe në Shtërpcë. Pasi Presidenti Thaçi vizitoi shkollat fillore nëpër Kosovë, partia rivale LDK e akuzoi atë se po bën fushatë për ish partinë e tij PDK dhe me këtë ishte duke e shkelur

⁶ Raportet për shfrytëzimin e pozitës publike në Viti; përdorimi i veturave me targa zyrtare në tubimin e PDK-së në Prizren dhe raportet e shfrytëzimit të veturave zyrtare në tubimet e LDK-së dhe PDK-së në Viti; komuna e Malishevës pretendohet se e ka favorizuar Nismën në hapësirën e postimit.

Kushtetutën.⁷ Nga disa rajone janë marrë pretendime se ka pasur presion dhe frikësim të votuesve.⁸

Kandidatet femra nuk e kanë gëzuar mbështetjen e njëjtë për fushatat e tyre nga subjektet e tyre politike. Paratë dhe mbulimi nga mediat ishin bërë me prioritet për kandidatët meshkuj. Gratë rrallë ishin në pozita drejtuese në ekipet e fushatave.⁹ Kandidatet femra rrallë folën në tubime dhe pjesëmarrja e grave në jetën publike pothuaj nuk u diskutua asnjëherë.

MEDIAT

Ambienti mediatik ka qenë i gjallë dhe pluralist dhe u ka mundësuar votuesve të kenë qasje në informata për opsionet e ndryshme politike. Legjislacioni për mediat ofron një kornizë të shëndoshë për lirinë e mediave dhe gazetarët në përgjithësi ishin në gjendje të ushtrorjnë profesionin e tyre lirshëm. Ligji për zgjedhjet kërkon nga të gjitha mediat mbulim të drejtë dhe të barabartë të garuesve, lejon reklamën me pagesë dhe parasheh qasje në kohë të transmetimit pa pagesë për të gjitha subjektet politike nga transmetuesit që pranojnë reklamën me pagesë. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), që është përgjegjës për mbikëqyrjen e mediave transmetuese, luajti një rol pasiv duke mos lëshuar asnjë deklaratë të shkruar publike lidhur me zgjedhjet ose vendim për shkeljet e zbuluara para dhe gjatë fushatës zgjedhore.

Televizioni dhe mediat e lajmeve online ishin burimi primar i informimit për votuesit. Ato gjerësisht mbuluan zgjedhjet në formate të ndryshme dhe nuk përdorën gjuhë nxitëse.

Kanalet televizive kryesore publike dhe private raportuan ndërhyrje nga partitë politike, të cilat u përpoqën të vënë kushte për debatet zgjedhore që do tu jepnin atyre trajtim të favorshëm duke e shkelur kështu ligjin. Këto përpjekje të raportuara rezultuan në vështirësi për mediat që të organizonin debate të lira dhe gjithëpërfshirëse, të cilat kanë qenë praktikë për një kohë të gjatë në Kosovë, duke dëmtuar kështu votuesit.

Kanali i televizionit publik *RTK1*, dhe dy kanale televizive private *RTV 21* dhe *KTV*, ofruan në lajmet e tyre një mbulim mjaft të paanshëm të tre garuesve kryesorë, përderisa stacioni televiziv privat *Klan Kosova* ofroi mbulim dukshëm më të madh për koalicionin PAN.¹⁰ Përveç spoteve të reklamave politike me pagesë, garuesit kryesorë bënë gjerësisht fushatë në televizion duke shfrytëzuar një mangësi në ligj, e cila u mundëson kanaleve televizive të transmetojnë pa kufi programe të sponsoruara, dhe dështon të përshkruajë kushtet e barabarta për blerjen e tyre. Televizioni publik *RTK2* ofroi mbulim me lajme shumë të kufizuar por të balancuar të partive politike të serbëve të Kosovës, derisa kanalet televizive private *TV Most* dhe *TV Puls* pothuaj ekskluzivisht e mbuluan Listën Serbe.¹¹

Mediat e lajmeve online mbuluan gjerësisht fushatën zgjedhore; megjithatë, shumica e mbulimit ishte e bazuar në informatat e marra nga agjencitë e lajmeve, nga burimet e tjera

⁷ Neni 83 i Kushtetutës përcakton se Presidenti “përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës”; Neni 88 ia ndalon Presidentit që të ushtroi ndonjë funksion të partisë politike.

⁸ EU EOM raportoi se punonjësve të institucioneve publike në Shtërpcë pretendohet se u janë kërkuar dokumentet e tyre të identifikimit, me sqarimin se do tu kthehen vetëm pas ditës së zgjedhjeve, dhe disa raste të frikësimit të votuesve në Novobërdë

⁹ Ekipi i fushatës së koalicionit të LDK-së në Gjakovë.

¹⁰ Tre garuesit kryesorë të mbuluar nga kanalet televizive ishin koalicioni PAN, koalicioni LDK-AKR dhe Vetëvendosje.

¹¹ EU EOM monitoroi *RTK1*, *RTK2*, *RTV 21*, *KTV* dhe *Klan Kosova TV* gjatë fushatës zgjedhore nga 17:00 deri në 01:00, emisionet e lajmeve në kohën me shikueshmëri të lartë të *TV Most* dhe *TV Puls*, dhe një mostër e mediave të lajmeve online.

mediatike dhe nga komunikatat për shtyp të partive politike dhe faqet e Facebook-ut. Po ashtu janë vërejtur raste të izoluar të faqeve të internetit me lajme dhe faqe të Facebook-ut të krijuara për të përhapur lajme të rrejshme dhe çorientuese, përfshirë edhe një exit poll të rrejshëm në ditën e zgjedhjeve.

SHOQËRIA CIVILE DHE VËZHGUESIT VENDORË

Demokracia në Veprim, një koalicion i OJQ-ve, është grupi kryesor vendor për vëzhgimin e zgjedhjeve. Ai shpërndau në terren mbi 2,500 vëzhgues dhe publikoi disa raporte për fushatën zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.

Një numër befasisht i madh i vëzhguesve (4,548) nga një OJQ e quajtur Instituti Rajonal i Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Studimeve Politike aplikoi për akreditim në KQZ në ditën e fundit. Anëtari i KQZ-së i caktuar nga Vetëvendosje ngriti shqetësimet se kjo është duke u keqpërdorur nga subjektet politike si mbulesë për të pasur vëzhgues shtesë të akredituar të partisë, që u ngrit edhe nga bashkëbiseduesit e tjerë në ditën e zgjedhjeve.

MBROJTJA E VOTËS

Nuk janë zbatuar disa masa shumë bazike kundër mashtrimit: asnjë referencë për dispozitat e Kodit Penal mbi krimet zgjedhore nuk është cekur në Doracakun e Procedurës së Vitimit dhe Numërimit, i cili është edhe baza kryesore e shkruar për trajnimin e stafit të zgjedhjeve, kështu që nuk është siguruar përfshirja në trajnime e materialeve për luftimin e mashtrimit. Po ashtu, referenca për ankesat në ditën e zgjedhjeve në Doracak është reduktuar në ofrimin e formularit të ankesës për palët e interesuara, por as shpërndarja e këtyre formularëve nuk është ndihmuar nga KQZ.

Në ditën e zgjedhjeve, Koordinatorin Kombëtar i Zgjedhjeve në Prokurorinë e Shtetit organizoi një dhomë të kontrollit, e cila mundësoi përgjigjen e menjëhershme në pyetjet lidhur me shkeljet dhe autorizimin e arrestimeve në tërë Kosovën.

ZGJIDHJA E KONTESTEVE ZGJEDHORE

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është institucion i pavarur i përbërë nga gjyqtarë përgjegjës për të gjykuar parashtresat lidhur me zgjedhjet dhe ankesat kundër vendimeve të KQZ-së. Deri në ditën e zgjedhjeve, PZAP ka pranuar gjithsejtë 171 ankesa kundër shkeljeve të pretenduara zgjedhore dhe 18 ankesa kundër vendimeve të KQZ-së. Shumica e ankesave kishin të bënin me shkeljet e Kodit të Sjelljes gjatë fushatës.

Paneli ka mbajtur dy seanca dëgjimore në procedurat e ankesës lidhur me certifikimin e kandidatëve të subjekteve politike që synonin përfaqësimin e komuniteteve joshumicë. Megjithatë, deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura në seanca u diskutuan vetëm në mënyrë shumë të kufizuar në vendimet që rezultuan nga PZAP. PZAP-ja hodhi poshtë ankesën e partisë turke KTAP duke u bazuar në atë se KTAP kishte hequr “vullnetarisht” kandidatët e tyre para certifikimit nga KQZ pa e diskutuar faktin se KTAP nuk do të certifikohet me kohë për hedhjet të shortit për fletëvotim, po të mos pajtohej të hiqte kandidatët. Ky vendim u mbështet nga Gjykata Supreme, prapë me deklaratën se KTAP kishte hequr “vullnetarisht” kandidatët.

PZAP ia shqiptoi një gjobë prej 25.000 EUR Listës Serbe për një video të fushatës që e konsideroi si shkelje të Kodit të Sjelljes së partive politike, respektivisht nenit 33.1 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, në mënyrë specifike për fyerje dhe nxitje të urrejtjes. Lista Serbe u ankua kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme me 10 qershor. Rreth 131 ankesa janë

parashtruar lidhur me ditën e zgjedhjeve, shumica për shkeljen e heshtjes zgjedhore dhe 32 lidhur me votimin dhe numërimin.

DITA E ZGJEDHJEVE

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë, pa incidente të mëdha të regjistruara nga vëzhguesit EU EOM-së. Vendvotimet përgjithësisht u hapën me kohë dhe ishin të përgatitura për votim. Kryesisht u respektua procedura e hapjes dhe hapja u vlerësua pozitivisht në të gjitha vendvotimet e vëzhguara.

Në përgjithësi, procesi i votimit u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në 97% të vendvotimeve. Megjithatë, disa subjekte politike vendosën më shumë se nga dy vëzhgues të akredituar në një numër të konsiderueshëm të vendvotimeve, çka paraqet shkelje të ligjit për zgjedhjet.¹² Në disa raste, kjo mund të ketë pasur efekt negativ tek votuesit për të votuar pa presion. Përveç kësaj, disa parti politike shpërndan përkrahësit e tyre si vëzhgues të akredituar të OJQ-ve, duke e përkeqësuar edhe më shumë problemin.¹³

Përderisa procedurat e votimit në përgjithësi u respektuan, vëzhguesit e EU EOM vërejtën shumë raste të votimit familjar (në 18 % të vëzhgimeve), ndonjëherë të kombinuara me votimin nga dikush tjetër (në 4% të vëzhgimeve). Disa votues u detyruan të kthehen prapa në 16% të vendvotimeve të vëzhguara, kryesisht sepse kishin ardhur në vendvotimin e gabuar. Një numër i madh, rreth 39% e qendrave të votimit nuk ishin të qasshme për votuesit me aftësi të kufizuara. Gjatë ditës së zgjedhjeve, heshtja zgjedhore u shkel nga disa kanale televizive private që transmetuan deklaratat e anëtarëve të partive politike.

Numërimi i votave u vlerësua më negativisht nga vëzhguesit e EU EOM-së, kryesisht për shkak se KVV-të jo gjithmonë i ndiqnin procedurat e numërimit, e cila duket të ketë ndodhur për shkak të kompleksitetit të procesit si dhe mungesës së trajnimit adekuat, duke çuar kështu në vështirësi për disa KVV që të plotësojnë si duhet protokollat e rezultateve. Në disa raste, vëzhguesit e akredituar janë parë duke ndërhyrë në proces.

KQZ raportoi për një dalje në zgjedhje prej 41.45% dhe filloi publikimin e rezultateve preliminare sipas vendvotimeve për partitë politike brenda disa orësh pas mbylljes, duke përmirësuar kështu transparencën e rezultateve.¹⁴

Vëzhguesit e EU EOM-së përcollën pranimin e materialeve zgjedhore në 16 komuna dhe e vlerësuan pozitivisht procesin. Prosesi i vlerësimit të rezultateve të zgjedhjeve dhe numërimit të votave përmes postës dhe me kusht është duke vazhduar në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

¹² Koalicioni LDK/AKR dhe koalicioni PAN kishin më shumë se dy vëzhgues të akredituar në 17% dhe 27% të vendvotimeve.

¹³ Për shembull, OJQ-ja e panjohur "Instituti Rajonal për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Studime Politike.

¹⁴ Rezultatet për kandidatët individualë do të publikohen vetëm bashkë me rezultat e konfirmuara përfundimtare.